



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1614, datë 22.06.2011

Për

“Shqyrtimin e Ankimimit administrativ të Neofone sh.p.k., ndaj Vendimit nr. 1559 datë 20.04.2011, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit të Vodafone Albania sh.a.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 22.06.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimin e Ankimimit administrativ i Neofone sh.p.k., ndaj Vendimit nr. 1559, datë 20.04.2011, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit të Vodafone Albania sh.a,

BAZA LIGJORE:

- Pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 9918*);
- Neni 137, e vijues të Ligjit nr.8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
- Rregullore nr. 13, datë 16.04.2010, “Për portabilitetin e numrit”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 1219, datë 07.04.2010;

- Pika 17, e nenit 21, të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138, të Ligjit nr. 9918;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa me nr. 81 Prot., datë 19.05.2011, (AKEP: nr. 703/7 prot, datë 23.05.2011 e sipërmarrësit Neofone sh.p.k, i cili ka paraqitur ankimin administrativ me objekt “Për disa ndryshime e shtesa në Vendimin nr. 1559 datë 20.04.2011, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit të Vodafone Albania sh.a.”;
- Vendimi nr. 1559, datë 20.04.2011, të Këshillit Drejtues të AKEP, Për disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit të Vodafone Albania sh.a.”;
- Vendimi nr. 1468, datë 23.12.2010, të Këshillit Drejtues “Për miratimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit të Vodafone Albania sh.a.”;
- Projektvendimin mbi shqyrtimin e ankimit administrativ të Neofone sh.p.k., ndaj Vendimit nr. 1559 datë 20.04.2011, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit të Vodafone Albania sh.a.”;
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);
si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

- I. Neofone sh.p.k., me anë të ankimit administrativ me nr. 81 Prot., datë 19.05.2011 kërkon:
1. Në seksionin I, Përmbledhje, të shtohet pika “n” (pika 1/a, e Vendimit nr. 1559, dt. 20.04.2011), si më poshtë:

Kjo Ofertë Referencë Interkoneksioni mbulon terminimin/origjinimin për thirrjet drejt/nga Pajtimtarëve/abonentët e rrjetit Vodafone Albania, të cilat janë ata abonentë që:

- *Kanë numër celular që i përket serive numerike (069 xx xxxx) të alokuar nga AKEP Vodafone Albania, numër i cili nuk është portuar në rrjetin e një operatori tjetër, ose*
- *Kanë numër që nuk i përket serive numerike të alokuar nga AKEP Vodafone Albania, por që është portuar në rrjetin e Vodafone Albania.*

Në rastin kur operatorit Vodafone i dorëzohet nga një operator çfarëdo brënda Republikës së Shqipërisë një thirrje që i përket serive numerike (069xxxxxx) të alokuara nga AKEP për Vodafone por të portuara nga një operator tjetër, atëherë operatori Vodafone është i detyruar t’a rrugëzojë këtë thirrje drejt operatorit që e ka portuar numrin përkatës. Në këtë rast operatorit Vodafone tarifon operatorin që i ka dorëzuar thirrjen me një tarifë shtesë prej 50 lekë/min.

Vodafone ka detyrimin të pranojë për terminim të gjitha thirrjet telefonike të destinuara për abonentët/pajtimtarët e Vodafone, të cituar më sipër pa kosto shtesë duke aplikuar tarifat normale të terminimit, dhe është përgjegjësia e operatorit përfitues të rrugëzohje thirrjet drejt rrjetit të duhur për numrat e portuar, duke bërë analizën e thirrjeve në përputhje me rregullat e vendosura nga AKEP për portabilitetin e numrave dhe rrugëzimin e thirrjeve drejt tyre me qëllim që të mos ketë kosto shtesë në terminim.

Por në rastet kur operatori dorëzues i thirrjeve i dërgon operatorit Vodafone një thirrje me seri numerike (069xxxxxx) e cila është portuar në një rrjet të ndryshëm nga ai i Vodafone, atëherë operatori Vodafone tarifon operatorin dërgues të thirrjes me tarifën shumatore:

$T = \text{Tarifë terminimi për minutë} + 50 \text{ lekë/min. (kosto shtesë për rrugëzimin gabim)}$

2. Për sa më sipër, Neofone argumenton se:
 - 2.1 Duke mos i prishur thirrjet e parrugëzuara mirë, por duke aplikuar një tarifë shtesë 50 lekë/min kundrejt operatorit dorëzues të thirrjes, operatori Vodafone Albania sh.a përmbush misionin kryesor të një kompanie telekomunikacioni për të ofruar me çdo kusht shërbim abonentëve fundorë;
 - 2.2 Abonenti nuk mund të quhet fajtor nëse operatori nga i cili tranzitohet thirrja e këtij abonenti nuk mund të rrugëzohje thirrjet në menyrë korrekte;
 - 2.3 Nisur nga ky fakt është normale që kostot e rrugëzimit gabim të bien mbi operatorët të cilët nuk rrugëzojnë thirrjet në mënyrë korrekte duke aplikuar një tarifë shtesë me kosto më të lartë financiare me qëllim që t'i detyrojë operatorët të rrugëzojnë thirrjet optimalisht duke i ofruar në çdo rast shërbim abonentit fundor si misioni primar i kompanive të telekomunikacionit;
 - 2.4 Në tregun shqiptar aktualisht, ka shumë operatorë tranzitues që nuk i japin rëndësinë e duhur rrugëzimit optimal të thirrjeve pasi thirrjet drejt numrave të portuar kanë volume të vogla dhe kostua financiare nëse këto thirrje nuk realizohen është zero;
 - 2.5 Sistemi i propozuar nga Neofone sh.p.k. krijon terrenin e duhur për përmbushjen e disa objektivave njëherësh:
 - Abonenti merr në çdo rast shërbimin e kërkuar pasi ka formuar numrin marrës në menyrë korrekte;
 - Operatori që nuk e kryen rrugëzimin korrekt të numrit të portuar me seri (069xxxxxx) nuk i pritët thirrja por të aplikohet një tarifë e lartë me qëllim që të përgigjet financiarisht për mosoperimin në mënyrë korrekte.
 3. Neofone sh.p.k konsideron se sygjjerimi i tij, bazohet në kuadrin rregullator të vendeve të BE-së, ku misioni primar është t'i ofrohet shërbim abonentëve fundorë në të gjitha situatat e mundshme;
 - II.** Gjithashtu Neofone sh.p.k. nëpërmjet këtij ankimimi kërkon nga AKEP të ndërmarrë edhe disa shtesa e ndryshime të tjera në Vendimin nr. 1468, datë 23.12.2010, të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit të Vodafone Albania sh.a”;
- Për sa më sipër, Neofone sh.p.k. kërkon që Këshilli Drejtues, të dalë me një vendim i cili të përcaktojë qartë:

1. Heqjen e tarifimit për sekondë të kohës që abonenti përdor sistemin IVR të operatorit alternativ plus kohën e rënies së ziles tek abonenti fundor për shërbimin e kartës së parapaguar;
2. Vendosjen e një tarife fikse zero lekë ose minimale për çdo thirrje të sistemit IVR të operatorit alternativ nga operatori FNT, në rast se abonenti fundor nuk i përgjigjet thirrjes me sukses;
3. Vendosjen e tarifimit për sekondë që nga momenti që abonenti i thirrur fundor i përgjigjet thirrjes me sukses dhe abonenti merr shërbimin e kërkuar.

III. AKEP për sa i përket pretendimeve të ngritura në ankimimin administrativ të sipërmarrësit Neofone sh.p.k., arsyeton si më poshtë:

1. Ankimi administrativ i paraqitur nga sipërmarrësi Neofone sh.p.k. me nr. 81 Prot., datë 19.05.2011 mbi Vendimin nr. 1559, datë 20.04.2011 të KD të AKEP është në përputhje me pikën 1, të nenit 140, të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
2. AKEP në lidhje me ndryshimin e propozuar nga Neofone në gjurmën n) të Seksionit I përmbledhje te pika 1/a, të Vendimit nr. 1559, dt. 20.04.2011, vlerëson se:
 - a. Vendosja e detyrimit mbi operatorin celular që të rrugëzojë thirrjet drejt numrave të serive numerike të tij, por të portuara në një rrjet tjetër celular, kur këto thirje vijnë gabimisht nga çfarëdolloj operatori në RSH, është një zgjidhje e ndryshme nga metoda e ACQ e përcaktar në rregulloren e portabilitetit, pra dhe do të binte ndesh me të;
 - b. Zgjidhja që ka bërë AKEP për RIO-t e operatorëve celularë me Vendimet nr.1559, nr. 1560 dhe nr.1561, datë 20.04.2011, përcaktimet në Vendimin nr.1581, datë 26.04.2011, si dhe sqarimet e dhëna për operatorët me shkresën nr. 728/2 prot., datë 10.06.2011, janë në përputhje me Rregulloren nr.13, datë 16.04.2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, duke i shërbyer qëllimit që procesi i portabilitetit të numrit të jetë i suksesshëm dhe ndihmojnë në realizimin e objektivit kryesor që është mbrojtja e interesave të përdoruesve të shërbimeve telefonike në mënyre që përdoruesit që transferojnë numrin tek një operator tjetër të mos kenë probleme me thirrjet e marra (hyrëse).
3. AKEP, në lidhje kërkesën e 2-të të Neofone mbi disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 1468, datë 23.12.2010, të Këshillit Drejtues “Për miratimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit të Vodafone Albania sh.a”, me shkresës me nr. 731/1 prot, dt. 18.05.2011 i ka kthyer përgjigje Neofone mbi ankimin e tij me nr. 79 prot, datë 25.04.2011 “Për disa ndryshime në RIO-t e operatorëve AMC sh.a, Vodafone Albania sh.a dhe Altelecom sh.a në lidhje me ofrimin e shërbimit të kartës së parapaguar”, duke bërë me dije Neofone për mos pranimin e ankimit administrativ për shkak të kalimit të afatit një mujor të parashikuar në nenin 140, të K.Pr.A.

Gjithashtu AKEP nëpërmjet kesaj shkrese ka sqaruar Neofone mbi objektin e ankimit si më poshtë:

- *Teksti që ju kundërshtoni, në lidhje me mënyrën e tarifimit për thirrjet e origjinuara drejt OSHKP, është i njëjtë me përcaktimin e RIO-s së Altelecom sha të miratuar me VKD nr.630, datë 10.02.2009, me të cilin ju keni punuar dhe jeni duke punuar aktualisht;*

- Në rastin e cituar thirrje e sukseshme quhet kur përgjigjet platforma e OSHKP dhe për sa kohë pajtimtari i operatorit celular (apo i operatorit Albtelecom) është në komunikim me platformën e OSHKP, konsiderohet thirrje e sukseshme dhe e tarifueshme nga operatori celular ofrues i shërbimit akses origjinimit, si origjinim thirrje për OSHKP.

Për sa më sipër, AKEP në lidhje me kërkesën e 2-të të Neofone për disa shtesa e ndryshime të tjera në Vendimin nr. 1468, datë 23.12.2010, të Këshillit Drejtues “Për miratimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit të Vodafone Albania sh.a” mban po të njëjtin qëndrim si në shkresën nr. 731/1 prot, dt. 18.05.2011 drejtuar Neofone sh.p.k,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 137 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17, të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Rrëzimin e ankimimit administrativ të Neofone sh.p.k me nr. 81 prot., datë 19.05.2011(AKEP: nr. 703/7 prot, datë 23.05.2011) “Për disa ndryshime e shtesa në Vendimin nr. 1559, datë 20.04.2011, të Këshillit Drejtues të AKEP;
2. Lënien në fuqi të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 1559, datë 20.04.2011, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit të Vodafone Albania sh.a.”;
3. Të njoftohet Neofone sh.p.k. për zbatimin e këtij Vendimi;
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURÇE**